STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 28 shkurt 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON PROGRAMIN E DFS QE BANKAT TE TAKOHEN PERSONALISHT ME PRONARET E SHTEPIVE QE KERKOJNE PARATE E ZGJEDHJES SE SIGURIMEVE PER SENDIN (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se pesë nga bankat dhe agjencitë më të mëdha të hipotekave të Nju Jorkut (New York) do të kenë përfaqësues në dispozicion për të ofruar ndihmë personalisht për pronarët e shtëpive që kërkojnë dhënien e fondeve për zgjidhjen e sigurimeve nga super stuhia Sendi (Sandy) në Qendrat e Ndihmës për Katastrofën (Distaster Assistance Centers) të Departmentit të Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) nga 4 marsi deri të shtunën, 9 mars.

Programi synon të ndihmojë pronarët e shtëpive që të përfundojnë hapat e nevojshme që bankat e tyre të firmosin çeqet e tyre per zgjidhjen e sigurimeve, të cilat shpesh janë lëshuar së bashku për pronarët e shtëpive dhe bankat ose agjencitë e tyre. Përfaqësuesit e bankave gjithashtu do të jenë në gjendje që të ndihmojnë njerëzit që janë duke u ndeshur me vështirësi në pagimin e hipotekave të tyre.

Pesë bankat dhe agjencitë e shërbimeve që marrin pjesë janë JPMorgan Chase, Wells Fargo, Bank of America, CitiMortgage dhe Ocwen Loan Servicing. Përveç tyre, përfaqësues nga Assurant do të jenë të pranishëm për llogari të shumë bankave dhe agjencive më të vogla të hipotekave.

Guvernatori Kuomo (Cuomo) tha: “Pronarët e shtëpive do të jenë në gjendje që të takohen personalisht me bankën ose agjencinë e hipotekës që ka hipotekën e tyre, kështu që nuk do të duhet të dërgojnë me postë dokumentat dhe çeqet andej dhe këtej. Këto banka janë duke u bashkuar me përpjekjen tonë dhe kjo duhet të ndihmojë që procesi të ecë më shpejt.”

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektor i Shërbimeve Financiare (Superintendent of Financial Services), tha: “Ky program do t’u japë pronarëve të shtëpive mundësinë e takimit personalisht me përfaqësuesit e bankave, në mënyrë që të marrin ndihmë me dokumentat, t’u jepen çeqet e zgjidhjes që u takojnë dhe të diskutojnë sesi të marrin ndihmë nëse janë duke u ndeshur me vështirësi me pagimin e hipotekave të tyre. Kjo duhet t’a bëjë procesin më të shpejt dhe më të efektshëm. Departamenti e vlerëson bashkëpunimin e bankave që marrin pjesë."

Siguruesit zakonisht japin çeqe së bashku për një pronar të shtëpisë dhe për bankën ose agjencinë e hipotekës të pronarit të shtëpisë pas zgjidhjes së një kërkesë të madhe për sigurimin. Kjo do të thotë se banka duhet të miratojë çekun përpara sesa pronari i shtëpisë të mund të përdorë fondet. Miratimi i dyfishtë është një kërkesë standarte e dokumentave të hipotekës dhe kontratave të sigurimit për të mbrojtur interesat e huadhënësit. Bankat gjithashtu mund të kërkojnë provë se riparimet janë bërë përpara sesa të miratojnë çeqet.

Më parë këtë muaj, Departmenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) zbuloi se bankat po mbanin më shumë se 200 milionë dollarë në fonde të sigurimeve nga viktimat e stuhisë Sendi (Sandy); Departamenti u bëri thirrje bankave që të përdorin autoritetin dhe përpjekjet maksimale për të përshpejtuar dhënien e fondeve dhe u kërkoi Fannie Mae dhe Freddie Mac të njoftojnë reforma urgjente të rregullave të tyre për t'u siguruar bankave dhe agjencive të hipotekave me edhe me shumë autoritet për të dhënë fonde.

Në përgjigje të kërkesës së Administratës Kuomo (Cuomo), Fannie dhe Freddie deklaruan se për huamarrësit që kishin bërë të gjitha pagesat e tyre përpara stuhisë dhe kanë më pak se 80% dëmtim të shtëpive të tyre, bankat dhe agjencitë e hipotekave kanë autoritet të plotë dhe të pakufizuar për të dhënë të ardhura nga sigurimet dhe duhet të zbatojnë të njëjtat praktika për huatë e tyre të mbështetura nga Fannie dhe Freddie ashtu siç bëjnë për huatë që ato banka dhe agjenci zotërojnë vetë, duke iu nënshtruar vetëm programeve të sigurimit të cilësisë.

Pas këtij udhëzimi të ri të Fannie dhe Freddie dhe diskutimeve të mëtejshme me administratën Kuomo (Cuomo), shumë banka tani po japin shumë më tepër para për huadhënësit. Me të vërtetë, vetëm këto pesë banka dhe agjenci të shërbimeve që marrin pjesë do të japin menjëherë rreth 70-80 milionë dollarë për huamarrësit e tanishëm si rezultat i këtyre ndryshimeve të rregullit.

Qendrat e Ndihmës për Katastrofën (Disaster Assistance Centers) të Departamentit do të gjenden në këto vendndodhje nga 9 e mëngjesit deri në 6 të pasdites, të hënën deri të premten dhe nga 9 e mëngjesit deri në 3 të pasdites të shtunën:

·Recreation Center and Ice Arena, 700 Magnolia Blvd., Long Biç (Long Beach).

·Cedar Creek Park, Merrick Rd. East, Siford (Seaford).

·Copiague Memorial Library, 50 Deauville Blvd., Kopag (Copiague).

·Averne by the Sea, 68-20 Rockaway Beach Blvd., Avern (Averne).

·Former Kia, 1976 Hylan Blvd., Stejtën Ajlënd (Staten Island).

Përveç kësaj, përfaqësues nga këto pesë banka së bashku me bankën OneWest (në një numër të

kufizuar) do të jenë në dispozicion në Qendrën e Lëvizshme të Komandës (Mobile Command Center) të Departamentit, e cila do të vizitojë vendndodhjet e mëposhtme:

E hënë, 4 mars 4 – 11 paradite deri në 7 pasdite, në 131 Irwin St, Manhattan Beach, Bruklin (Brooklyn).

E martë, 5 March – 10 paradite deri në 6 pasdite, në Lawrence Village Hall, 196 Central Ave., Lorens (Lawrence) në Qarkun Naso (Nassau County).

E mërkurën, 6 mars – 10 paradite deri në 6 pasdite, në Burns Park, 4990 Merrick Rd, East Massapequa, në Qarkun Naso (Nassau County).

E enjte, 7 mars – 10 paradite deri në 6 pasdite, në 2660 Hylan Blvd., Stejtën Ajlënd (Staten Island).

E premten, 8 mars – 10 paradite deri në 6 pasdite, në 112-15 Beach Channel Dr., Belle Harbor, Rokëuejs (Rockaways).

E shtunë, 9 mars – 10 paradite deri në 4 pasdite, në Holy Family Church, 9719 Flatlands Ave, Kanarsi (Canarsie), Bruklin (Brooklyn).

Klientët e bankave ose agjencive të hipotekave të tjera përveç institucioneve që marrin pjesë në këtë program gjithashtu inkurajohen të vizitojnë Qendrat e Ndihmës për Katastrofën (Disaster Assistance Centers) për të marë ndihmë në përgjigjen e pyetjeve të tyre. Pronarët e shtëpive me pyetje të përgjithshme në lidhje me sigurimin gjithashtu janë të inkurajuar të marrin pjesë.

Pronarët e shtëpive që nuk janë në gjendje të shkojnë në një Qendër të Ndihmës për Katastrofën (Disaster Assistance Center) mund të kontaktojnë Departmentin duke telefonuar (800) 339-1759, i cili është i hapur nga ora 8 e mëngjesit deri në 8 të pasdites, të hënën deri të premten dhe nga 10 e paradites deri në 5 të pasdites, të shtunën dhe të dielën. Informacioni mbi sigurimin është gjithashtu i disponueshëm në faqen në internet të Departamentit, www.dfs.ny.gov.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418